


*Historia frymëzuese e Flugenës
I dha vetes një shans të dytë, fitoi 'Më i Miri në Vend'!*
Flugena Fusha



Flugena, vajza e re nga Durrësi e cila vështirë se vinte gjumë në sy ditët e pjesëmarrjes në formatin televiziv "Më i Miri në Vend", sot ka arritur ta kthejë pasionin e saj lumturisht në profesion. Dhe pse tepër e talentuar, e kishte të vështirë të zgjidhte sektorin e shërbimit si sektorin ku do të përqëndrohej jeta e saj profesionale. Si u gjend Flugena sërisht në të njëjtin format televiziv? Si arriti të rëmbente kupën e fitores pasi këmbënguli të merrte pjesë sërisht në sezonin e dytë?

"Më i Miri në Vend" është një format televiziv që vendos në garë të rinj dhe të reja në sektorin e shërbimeve. Gjatë edicionit të 2021 ku ishte pjesëmarrëse edhe Flugena, fokusi ishte në profesionet e Hotelarisë dhe mundësitë për zhvillimin e karrierës brenda këtij sektori. Programi synon orientimin në karrierë të të rinjve duke prezantuar në format tërheqës, profesione të kërkua në treg, dhe me mbështetjen e ekspertëve të fushës ofron informacion të përditësuar dhe relevant mbi sektorin.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkepunim DSC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkepunim DSC

Në partneritet me:



MINISTRIA E TREGTISË
DHE EKONOMISË

Zbatuar nga:



Flugena ka pamje serioze dhe të shikon me qetësi. Uniforma serioze me xhaketë e fund të errët, kodi i veshjes që ka vendosur formula e emisionit "Më i Miri në Vend" i rri aq hijshëm saqë duket ideali për staturën që kërkon profesioni që ajo ëndërron. Performanca e saj ra në sy të ekspertëve që do të vlerësonin konkurrentët.

"Isha me studime master në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës për Menaxhim Turizmi dhe një pedagoge më sugjeroi të merrja pjesë në emisionin 'Më i Miri në Vend'. Herën e parë kam konkurruar për pozicionin e receptionistes. Isha studente dhe punoja si receptioniste në resortin Royal Hill në Durrës. Nuk e fitova konkursin, por nuk u dorëzova. Ishte kënaqësi që isha pjesë e asaj eksperience të bukur, por gjithmonë mendoja që nëse do më jepej përsëri mundësia, do rikonkurroja".

Kur konkurroi për herë të dytë, Flugena ishte rritur dhe në detyrë si asistente menaxhere. Dhe për t'u zhvilluar edhe më shumë si nga ana personale dhe profesionale, kishte nisur një trajnim 1-vjeçar për Drejtuese Hoteli në Akademinë e Hotelerisë dhe Turizmit (HAT). Aty ajo dëgjoji që emisioni "Më i Miri në Vend" kishte rifilluar audicionet, kësaj radhe me një fokus në pozicione drejtuese në sektorin e Hotelerisë. "Kështu vendosa të merrja pjesë sërish, më e fortë, më e bindur, më sfiduese dhe më e sigurtë". Ajo aplikoi për profesionin Menaxhere e Burimeve Njerëzore. Sipas Flugenës, ishte shumë e vështirë por plot emocione, që ajo thotë "...nuk do ti harroj kurrë". Me shumë vullnet dhe dëshirë Flugena zgjodhi të trajnohej nga dy trajnerët e emisionit, Gladiola dhe Skënderi. Pas konkurrimit Flugena arriti të fitojë "Më i Miri në Vend", të fitojë kupën dhe të dilte me

vlerësimin më të lartë në sfidën e realizuar mes tre konkurrentëve.

Padyshim që u ndjeva shumë mirë dhe që kisha arritur një nga qëllimet që i kisha vënë vetes. Kjo fitore iu shtua CV-së time. Tani punoj si Menaxhere në një hotel të madh prej 124 dhomash në Durrës.

Emisioni "Më i Miri në Vend" ishte orientimi i duhur dhe i nevojshëm për Flugenën, e cila pati mundësinë për t'i dhënë vetes një shans të dytë në këtë format, që rezultoi në një shans të dytë për karrierën e saj. Flugena tepër e emocionuar sot, thotë se ky emision ndikoi në jetën e saj në aspektin profesional, duke e ngritur në karrierë dhe emëruar si Menaxhere e Përgjithshme në Departamentin e Burimeve Njerëzore në Supreme Hotel në Durrës. Aktualisht ajo drejton 25 persona staf, ndërsa gjatë sezonit numërohen mbi 100 persona staf.

Rasti i Flugenës na frymëzon të mos dorëzohemi. Ajo nuk lejoi që të demotivohej kur nuk fitoi sfidën e parë. Ajo nuk fajësoi të tjerët por përkundrazi, mësoi nga kjo përvojë, u frymëzua që të punonte më shumë me veten për të arritur qëllimet e saj të karrierës. Flugena faktikisht ishte fituese që në momentin që e ktheu sfidën në një mundësi për rritje.

